

AKT THEMELIMI

i Shoqërisë "2D Construction" shpk

Sot, në **Tiranë**, më **01 Korrik 2022**, Unë Ortaku i Vetëm **Bardhyl Tefik Fusha** hartoj Aktin e Themelimit të shoqërisë **"2D Construction" shpk**, sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi, me dispozitat që vijnë:

Neni 1

Themelimi

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"(i ndryshuar), aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që i bashkangjitet këtij Akti Themelues.

- 1) Emri i shoqërisë është **"2D Construction" shpk** (këtu më poshtë e quajtur **"Shoqëria"**). Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 2) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj.

Neni 2

Selia

- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Tiranë, Njesia Administrative nr.1, Rruga Ali Sheqi, Godine 1 kat, Kod banese 1704-302 Shkoze.**
- 2) Shoqëria mund të themelojë degë në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3

Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- 1) Ndertime civile dhe industriale.
- 2) Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile, industriale, veshje fasadash.
- 3) Ndertim rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, etj.
- 4) Punime gërmimi në formacione të gjitha llojeve;
- 5) Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut dhe sinjalistika rrugore jondricuese.
- 6) Punime nentoksore, ura e vepra arti.



- 7) Punime për prishjen e ndertimeve.
- 8) Impjante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.
- 9) Impiante ngrites dhe transportues (ashensore, shkallë levizëse, transportues).
- 10) Punime rifiniture të muratues dhe të lidhura me to.
- 11) Import-eksport dhe tregëtim i materialeve të ndertimit e lendeve të para brenda dhe jashtë vendit.

Neni 4 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 5 Kapitali Themeltar dhe Ortaku i Vetëm

- 1) Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë, i përbërë nga 1 (një) pjesë vlere nominale e së cilës është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- 2) Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është **Bardhyl Fusha**, atësia **Tefik**, i dtl. **15/05/1968**, lindur në **Gramsh** dhe banues në **Tiranë**, identifikuar nga karta e identitetit me **Nr.038244485**.

Neni 6 Ortakët

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Neni 7 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- 1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- 2) Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë që i bashkëlidhet këtij akti.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, **Bardhyl Fusha**, atësia **Tefik**, i dtl. **15/05/1968**, lindur në **Gramsh** dhe banues në **Tiranë**, identifikuar nga karta e identitetit me **Nr.ID. G80515226R** i cilit zgjidhet për një afat për **5 vjet**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 8
Audituesit ligjorë

Audituesit ligjorë të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë Audituesin Ligjor.

Neni 9
Pjesëmarrja

Ortaku themelues mund të vendos me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

Neni 10
Ngritja e degëve apo filialeve

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

Neni 11
Ruajtja e Sekretit

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 12
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë, të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Neni 13
Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t'u administruar në baze të ligjit, një kopje për t'u dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe dy kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“2D CONSTRUCTION” shpk

Bardhyl Fusha

